

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2746/Prot.

Durrës, më 25. 11.2025

V E N D I M

Nr. 161, Datë 25. 11.2025

P Ë R

**"HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË, "DOKTORATË"
NË "MODELIMI I SISTEMEVE KOMPLEKSE DHE INTELIGJENCË
ARTIFICIALE", PRANË FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës".**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin e UAMD-së neni 5, neni 15, neni 59; në Rregulloren e UAMD-së; në shkresën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore të FTI me nr. 2703 prot., datë 20.11.2025, si edhe në relacionin Nr. 2703/1 prot., datë 21.11.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të tretë, "Doktoratë" në "Modelimi i Sistemeve Komplekse dhe Inteligjencë Artificiale", pranë Departamentit të Matematikës, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën: **Shqip dhe Anglisht.**
3. Kodi i programit të studimit: **83DO0688SA.**
4. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

